

URDHËR
Nr.156/1, datë 10.3.2020

**PËR NDALIMIN E TË GJITHA LËVIZJEVE TË UDHËTARËVE DREJT
ITALISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, gërmat “a” të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, vendimin e Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e lëvizjeve të udhëtarëve me mjetet e transportit ajror nga Aeroporti “Nënë Tereza, Tiranë drejt Italisë, deri në një urdhër të dytë.
 2. Ndalimin e lëvizjeve me mjetet e transportit detar nga të gjithë portet në vend drejt Italisë, deri në një urdhër të dytë.
 3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të bashkëpunojnë me Autoritetin Portual Durrës, Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe Tiranë International Aeroport.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**